



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMORI LËNDËS
Sintaksë e Gjuhës B

Ngarkesa në orë/kredite: 40 orë mësimore, 4 kredite, (20 leksione, 20 seminare)

Viti / Semestri: Viti I, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në “Përkthim dhe interpretim në gjuhën greke dhe angleze”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Sintaksa e gjuhës greke do të zhvillohet nga një perspektivë shpjeguese, që do të thotë se studimi dhe interpretimi i fjalive do të bëhet nga një pikëpamje e përgjithshme përshkruese. Studenti duhet të jetë i aftë: Të shpjegojë problemet që kanë të bëjnë me njësitë sintaksore themelore, si: fjalia e thjeshtë dhe gjymtyrët e saj kryesore; problemi i fjalisë së përbërë; nocionet e sintagmave në gramatikën e gjuhës greke, etj. Të përvetësojë dhe të zhvillojë aftësinë e të analizuarit dhe të komentuarit të teksteve dhe dokumentave të ndryshëm në fushën sintaksore të kësaj gjuhe.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të identifikojë dhe analizojë në mënyrë të detajuar të gjitha konceptet themelore dhe strukturat gjuhësore sintaksore të gjuhës greke, të tilla si pjesët kryesore dhe dytësore të fjalisë dhe tipat e ndryshëm të përcaktorëve, bashkë me nën-kategorizimin e tyre, fjalitë bashkërenditëse dhe nënrenditëse etj. Në fund të këtij kursi studenti do të jetë i aftë të analizojë pjesët përbërëse në nivel të fjalisë; të kategorizojë fjalitë varësisht nga struktura dhe mënyra e formimit të tyre.

Rezultatet e pritshme :

1. Të jetë i aftë në zgjidhjen e problemeve
2. Të jetë i aftë për të punuar në grup
3. Të jetë i aftë për të vënë teorinë në praktikë
4. Të jetë i aftë në të kuptuar
5. Të jetë i aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur